



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010 dhe të nenit 9 të Ligjit nr. 04/ L-016, për eficiency e energjisë, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 10.11.2020, miratoi këtë

V E N D I M
PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMUNAL TË VEPRIMIT PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË
(PKVEE) 2019 - 2021

Neni 1

Miratohet Vendimi për Planin komunal të veprimit për eficiency të energjisë (PKVEE) 2019 - 2021.

Neni 2

Plani i veprimit, i cekur në nenin 1 të këtij vendimi, është bazuar në mbledhjen e të dhënave nga situata aktuale, si dhe hartimit të planit nga konsulenca e angazhuar nga GIZ: EECG, falë bashkëpunimit dhe koordinimit me menaxherin komunal të energjisë dhe grupit punës të Komunës së Prishtinës.

Neni 3

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani komunal i veprimit për eficiency të energjisë (PKVEE) 2019 - 2021.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Kryetari i Komunës së Prishtinës dhe organet kompetente të Administratës komunale.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-030/01-0209804/20, më 12.11.2020

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

